



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3 të ligjit mbi eksproprijim ("Gazeta zyrtare e Kosovës nr.21/78"), nenit 3 a të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi eksproprijimin ("Gazeta Zyrtare e Kosovës nr.46/95"), nenit 202 të LPA-së, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2003 merr

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NDËRTIMI I
TRAFOSTACIONIT TS 110/35/10 KV "PRISHTINA 5" NË LAGJEN "KODRA E
TRIMAVE"

I

Përcaktohet se është në interes të përgjithshëm ndërtimi i Trafostacionit TS 110/35/10 KV, Prishtina 5 në lagjen "Kodra e Trimave" dhe ndërtimi i linjës së dyfishtë 110 KV, TC "Kosova A" – TS Prishtina 5.

II

Lejohet hapja e procedures për eksproprijim- bartje administrative të të drejtës në shfrytëzim për paluejtshëmërin që gjendet në territorin e Komunës së Prishtinës, përkatësisht në Zonën Kadastrale Shkabaj dhe Prishtinë që përfshihen ngastrat kadastrale të pronarëve të pronave të caktuara afërsisht në **Elobaratin Eksproprijues**, i cili është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtorati për Financa dhe Pronësi.

IV

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 351-266 DT. 04.03.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri